



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje sistem faturimi dhe arketimi

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

48444100-3 sistem faturimi

VLERA E FONDIT LIMIT: 11 800 000 (njembedhjetë milion e teteqind mijë) leke pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shoqëria Rajonale **Ujësjetlës Kanalizime sha Pogradec** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës shtojca 3;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1.Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori duhet të ketë të përfshirë në objektin e veprimtarisë në Ekstraktin e QKB edhe objektin e prokurimit të kësaj kontrate.

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe shtojcës 8 të DST-së.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatori ekonomik, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, duhet të paraqesin vërtetim të xhiros vjetore të realizuar, për vitet 2019,2020,2021, ku Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet ekonomikë nuk mund të tejkalohet: vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: " Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar

Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, është jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.2.2 Pasqyrat financiare për vitet (2019, 2020, 2021) të konfirmuara nga administrata tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave

financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mos shlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Pika e

Furnizime të mëparshme të ngjashme me një vlerë jo më të madhe se 40% të fondit limit të objektit të prokurimit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, vërtetuar me dokumentacionin vërtetues si më poshtë:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 *Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.* Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si

referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Operatori Ekonomik konkurues duhet të jete i certifikuar me:

- a) ISO 9001 (për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë) (ose ekuivalent) e perditesuar
- b) ISO 27001 (për Sigurinë e Informacionit) (ose ekuivalent) e perditesuar
- c) ISO 20000 (manaxhimi i shërbimeve IT), (ose ekuivalent) e perditesuar, e cila duhet të perkoje me kategorine dhe specifiken e produkteve dhe të shërbimeve që prokurohen.
- d) BS PASS 99:2012 (Menaxhimi i sistemeve të integruar) (ose ekuivalent) e perditesuar

Argumentimi: Kërkesa më sipër është vendosur në mbështetje të nenit 36, pika 3, e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku citohet:

“3.Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionale sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; 23 ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Nëpërmjet kësaj kërkesë Autoriteti Kontraktor kërkon garantimin e një shërbimi të vijueshëm dhe cilësor për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,

...“Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie...”

si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

... “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit...”

a) ISO 9001, për sistemin e menaxhimit të cilësisë:

ISO 9001 (ose ekuivalente) parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001 ose ekuivalente, është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

b) ISO 20000-1 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të shërbimit të teknologjisë së informacionit:

Standardi ISO 20000-1 (ose ekuivalente) përcakton kriteret për planifikimin, krijimin, menaxhimin, monitorimin, rishikimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e qasjes së menaxhimit të shërbimeve që fokusohen në teknologjitë e informacionit.

ISO 20000-1 është një kuadër standardizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomike për: ndjekjen konsistente të shërbimeve përgjatë afatit të zbatimit të kontratës, sipas kërkesave të DST-së.

Kjo çertifikatë ose ekuivalentja e saj, siguron Autoritetin Kontraktor që të gjitha shërbimet që do të realizohen përgjatë kohëzgjatjes së kontratës, do të menaxhohen sipas standardeve më të mira të shërbimeve të teknologjisë së informacionit.

c) ISO 27001 ose ekuivalente, për sistemin e menaxhimit të sigorisë së informacionit:

ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :

- mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.
- aplikimin e praktikave të sigorisë për menaxhimin e risqeve të sigorisë.
- aplikimin e praktikave të sigorisë për trajtimin e të dhënave sensitive.
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.

Referuar sa më sipër cituar, ky standard i kërkuar, lidhet ngushtësisht dhe drejtpërdrejtë me zërat e kërkuara objekt kontrate.

d) BS PASS 99:2012 (Menaxhimi i sistemeve të integruar) e perditesuar:

Standarti BS PASS 99:2012 përcakton kriteret për menaxhimin e sistemeve të integruara. Certifikimit Menaxhimi i Integruar tregon se Operatori Ekonomik i permbush të gjitha kriteret në lidhje me menaxhimin e sistemeve të integruara.

Zgjidhja e ofruar duhet të jete COTS (commercial-off-the-shelf). Ky Program nuk duhet të kete kosto licensash për instalime në ambient test, ambient zhvillimi dhe për shtimin e perdoruesve. Për të vertetuar kete kusht ofertuesit duhet të paraqesin:

- e) a. Autorizimi i Prodhuesit për implementim dhe zhvillim i cili të specifikojë titullin e procedurës, datën, adresën e qartë të prodhuesit dhe të bashkëngjise dokument që verteton pronesinë nga prodhuesi.
- f) b. deklaratën nga prodhuesi i sistemit ku përcaktohet qartë menyrën e licensimit të sistemit që kërkohet të implementohet.
- g) c. deklaratë nga prodhuesi që sistemi/moduli është i integruar me modulet e tjera sic kërkohet në specifikimet teknike duke i përmendur sakt emrat e sistemeve apo moduleve

me te cilat eshte i integruar dhe duke percaktuar qart menyren dhe informacionin qe eshte i integruar.

Argumentimi: Qe te sigurohet aftesia per implementimin e sistemit dhe bazuar ne proceset e punes kritike, rendesise se sherbimeve qe sistemi ofron kerkohet qe OE te ofroje nje sistem i cili eshte i gatshem dhe vetem do te implementohet.

Operatori Ekonomik duhet te jetë i licensuar nga AKSHI dhe DPT për sistemin efiskalizimit ose i autorizuar nga një prodhues i licensuar për shitjen e një produkti tëlicensuar të fiskalizimit

Argumentimi: Bazuar ne Ligjin Nr 87/2019 Për faturen dhe Sistemin e Monitorimit të Qarkullimit dhe Udhezim nr 16 date 03.04.2020 Për faturën dhe Sistemin eMonitorimit të Qarkullimit dhe Vendim Nr 239 datë 20.03.2020 Për Kërkesat teknike dhe funksionale të zgjidhjes software për procedurë e faturimit dhe tëfiskalizimit si dhe procedura për kriteret e regjistrimit e prodhuesve e temirëmbajtesve të zgjidhjeve software-ike duhet që operatorët të cilët ofrojnë këtëshërbim duhet të jenë të licensuar dhe te regjistruar në regjistrin e prodhuesve ose temirëmbajtesve software-ike te AKSHI-i

Për të vërtetuar që ka kapacitete njerëzore, profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë dhe sipas specifikimeve teknike të projektit, operatori ekonomik duhet të ketë te punesuar te pakten 5 punonjes te diplomuar ne fushen e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj). Plotesimi i ketij kriteri duhet te vertetohet me paraqitjen e formulareve E-SIG per periudhen e 3 muajve te fundit duke iu referuar dates se hapjes se ofertave dhe diplomave te shkollimit te larte universitar per secilin prej punonjesve. Keta punonjes duhet te jene te certifikuar si vijon:

- a. Operatori ekonomik duhet te kete te pakten 2 (dy) punonjes te certifikuar si “Ekspert te Çertifikuar” ne zhvillim dhe implementim e zgjidhjes se ofruar. Keto certifikata te jene te leshuara nga vete Prodhuesi ose Kompani e autorizuar nga prodhuesi per te leshuar certifikaten e siperpermendur dhe kjo Kompani te jete e licencuar nga Autoritetet Shteterore. Per te permbushur kete kriter Operatori ekonomik te paraqese:
 - Certifikatat “Ekspert te Certifikuar” per secilin punonjes.
 - Dokumentacionin per Prodhuesin ose Kompanine e autorizuar nga prodhuesi per leshimin e certifikates
 - Licenca e leshuar nga Autoritetet Shteterore per Kompanine e autorizuar nga prodhuesi per leshimin e certifikates.

Argumentim: Qe te sigurohet aftesia per implementimin e kerkesave per ndryshim, zgjidhja e incidenteve dhe problemeve, zgjerimi i funksionaliteve, etj, kerkohet qe OE duhet te kete ne stafin e propozuar te pakten 2 personel me njohuri/aftesi te nevojshme te certifikuara nga prodhuesi i teknologjive te sistemit

- b. Operatori ekonomik duhet te kete te pakten 1 specialist te certifikuar ne konceptet, inxhinierizimin e Web sherbimeve dhe protokollit SOAP. Keto certifikata garantojne qe programuesit jane te aftesuar ne zhvillimin e sistemeve me arkitekture te prirur drejt sherbimeve ne rrjet/sistemeve te shperndara.

Ky kriter te plotesohet me paraqitjen e certifikates perkatesen per punonjesin.

Argumentim: Specialisisti i sipercituar nevojitet per te garantuar integrimin mes sistemeve te brendshme dhe me sistemet e paleve te treta. Keto certifikata garantojne qe programuesit jane te aftesuar ne zhvillimin e sistemeve me arkitekture te prirur drejt sherbimeve ne rrjet/sistemeve te shperndara

- c. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) punonjes të certifikuar për zgjidhjen arkives digjiale që ka në përdorim AK.
 - Certifikata për secilin punonjes.
 - Dokumentacionin për Prodhuesin ose Kompaninë e autorizuar nga prodhuesi për leshimin e certifikates
 - Licenca e leshuar nga Autoritetet Shtetërore për Kompaninë e autorizuar nga prodhuesi për leshimin e certifikates.

Argumentim: Meqenëse sistemi kërkohet të jetë i bazuar në teknologji në web atëherë kërkohet që të ketë specialist të cilet e njohin këto teknologji.

- d. Operatori ekonomik duhet të ketë të paktën 1 (një) Arkitekt i Certifikuar në zgjidhje cloud për Programin e Fiskalizimit që do të ofrohet. Për të përmbushur këto kriter Operatori Ekonomik të paraqesë certifikatën përkatëse për këto punonjes:

Argumentim: Meqenëse Programi Fiskalizimit do të integrohet operojë në Cloud dhe do të integrohet me Programin e Leximit – Faturimit - Arketimit kërkohet të ketë një specialist për të garantuar integrimin.

App i lexuesve duhet të jetë i certifikuar nga prodhues PDA që ai app është i certifikuar për pajisje PDA.

Argumentim: Duke qenë se lexuesit të cilet punojnë për të mbledhur leximet e matësve aktualisht shfrytëzojnë pajisjet PDA për të mbledhur leximet dhe këto pajisje duhet të shfrytëzojnë baterinë dhe resurset e pajisjes në mënyrë optimale, duhet që app për PDA të jetë i certifikuar për pajisje PDA.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të jetë i autorizuar nga prodhuesi i arkives digjitale që AK ka në përdorim, për zhvillime dhe integritet në këto produkt në këto implementime. Për të plotësuar këto kriter operatori ekonomik duhet të dorëzojë:

- Autorizim nga prodhuesi i sistemit të arkives digjitale i cili të specifikojë titullin e procedurës, datën, adresën e qartë të prodhuesit dhe të bashkëngjijë dokument që verteton pronesinë nga prodhuesi.

Argumentim: Duke qenë se AK përdor sistemin e arkives digjiale dhe kërkon që sistemi informatik i menaxhimit të integrohet me këto sisteme, kërkon garanci dhe mundësi nga operatori ekonomik që do të kryejë këto detyra. Autorizimi i jep garanci AK që operatori ekonomik mund ta kryejë këto detyra me sukses dhe në standardin dhe specifikimet e kërkuara.

2.3.8 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë oferta teknike që përmbush specifikimet teknike të dhëna në shtojcën përkatëse.

Komisioni